

Respektimi i Integritetit në Shërbimin Civil:

Transparencë-Mirëqeverisje-Parandalimi i shkeljeve-Përgjegjshmëri



Lufton..



Mbështet...



- ▶ INSTITUCIONET PUBLIKE DUHET TË ADOPTOJNË DHE ZBATOJNË PARIMET E MIRËQEVERISJES DHE TË INTEGRITETIT TË PUNONJËSIT CIVIL.
- ▶ MIRËQEVERISJA DHE RESPEKTI I INTEGRITETIT JANË PARAKUSHTE PËR NJË PUNË EFIKASE NË SHËRBIM TË INTERESIT PUBLIK.

MIRËQEVERISJA E INSTITUCIONIT PUBLIK FILLON ME:

- demonstrimin publik dhe me fakte nga titullari të përkushtimit real ndaj integritetit në punë dhe qeverisjes së mirë;
- ushtrimin e kompetencave dhe profesionalizmit me integritet nga titullari deri tek specialisti, përfshirë edhe anëtarët e kabinetit dhe ekspertët e jashtëm.

"PËRGATITJA E PLANEVE TË RESPEKTIMIT SË INTEGRITETIT ËSHTË DETYRIM LIGJOR DHE HAP I DOMOSDOSHËM PËR TË RRIUR EFICIENCËN E PUNËS SË INSTITUCIONIT SHTETËROR DHE TË NËPUNËSVE."



Kjo fletëpalosje është përgatitur nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim në kuadër të projektit "Përputhshmëria me Integritetin: Vendosja e Shembullit me Standardet më të Përparuara" me mbështetjen e Ambasadës së Hollandës.

HAPAT E PËRGATITJES SË PLANEVE TË INTEGRITETIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE

ANALIZA E RISKUT TË INSTITUCIONIT

- identifikon në mënyrë efektive rreziqet që mund të prekin integritetin e punonjësve dhe të procedurave në institucion dhe në agjencitë e varësisë;
- identifikon dhe harton masat që adresojnë këto rreziqe.

PËRGATITJA DHE PËRSHTATJA E PROCEDURAVE TË BRENDSHME SIPAS SPECIFIKAVE TË INSTITUCIONIT

Përfshin:

- Përshtatjen e Rregullores së Brendshme, e organigramës, përgatitjen e formularëve të Respektimit të Integritetit, adoptimin e tyre sipas rregullave në fuqi, dhe komunikimin e tyre tek të gjithë punonjësit dhe ofruesit e shërbimeve.

MEKANIZMAT E MONITORIMIT

- Ndërtimi dhe adoptimi i mekanizmave të qartë të monitorimit dhe raportimit janë pjesë e domosdoshme;
- Përcaktimi i personit/sectorit përgjegjës për monitorimin e planit dhe për auditimin, dhe mbështetja e tyre me burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme, janë detyrim përkundrejt suksesit të monitorimit.

KRIJIMI I KULTURËS INSTITUCIONALE TË TRANSPARENCËS DHE I NJË KOMUNIKIMI EFIKAS

Përfshin:

- ndërtimin e planeve të komunikimit dhe informimit;
- ndërtimin e mekanizmave të sigurt të raportimit nga ana e punonjësve;
- ndërtimin e një reputacioni ekselent të institucionit në imazhin e qytetarit.

PËRGATITJA E TRAJNIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT MBI BAZA TË RREGULLTA SI PJESË E PUNËS SË PËRDITSHME

Përfshin:

- Përgatitjen e planeve të trajnimit në përputhje me profilin e institucionit dhe / ose departamentit;
- organizimin e sesioneve të trajnimit në përputhje me planet;
- organizimin e shkëmbimeve me institucionet simotra brenda dhe jashtë vendit;
- promovimin e praktikave të mira brenda dhe jashtë vendit.

DISA MASA KONKRETE TË PLANIT TË RESPEKTIMIT TË INTEGRITETIT NË INSTITUCIONIN PUBLIK

VIZIONI I INSTITUCIONIT

Përkushtimi i qartë dhe publik i autoriteteve më të larta është elementi kyç në ndërtimin dhe zbatimin e suksesshëm të një kulture integriteti.

Përfshin:

- publikimin e vizionit në faqen zyrtare të institucionit;
- nënvizimin dhe përkushtimin e titullarit për rritjen e transparencës, respektimin e integritetit në të gjitha nivelet e menaxhimit; dhe përmirësimin i sistemeve të planifikimit dhe kontrollit financiar në institucion.

RREGULLORET DHE PROCEDURAT E BRENDSHME

Transpozimi i vizionit në rregulla të thjeshta, të kuptueshme, të zbatueshme dhe të qarta për të gjitha degët e institucionit mundëson:

- detyra dhe funksione të qarta;
- ndarjen e detyrave duke shmangur konfliktin e interesit;
- funksionalitetin dhe mekanizmat e monitorimit të përputhshmërisë së integritetit;
- zbatimin e rregullave për menaxhimin e bazës së të dhënave në lidhje me raportimet e bëra nga punonjësit.

KODI I ETIKËS

Kodi i Etikës është element thelbësor i menaxhimit për të gjitha institucionet dhe i detyrueshëm për të gjithë punonjësit.

Kodi sqaron dhe rregullon:

- vizionin e institucionit në lidhje me integritetin;
- parimet e etikës dhe integritetit në punë;
- vendos standarde të qarta të respektimit të integritetit dhe përcakton sanksionet për shkeljen e tyre;
- detyron të gjithë punonjësit ta njohin dhe të shprehin me shkrim dakordësinë e tyre.



PROCEDURAT MBI DHURATAT DHE MIKËPRITJEN

Bën transparente konceptin e dhuratës dhe modalitetet rregulluese, që duhet të jenë:

- të thjeshta, të shkurtra dhe lehtësisht të zbatueshme;
- të përcaktojnë çfarë mund të pranohet dhe çfarë jo.

REGJISTRI I DHURATAVE DHE MIKËPRITJES

Sigurohet që dhuratat dhe mikëpritjet regjistrohen në mënyrë të rregullt.

Regjistri duhet të jetë:

- lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë punonjësit;
- të bazohet mbi mjete teknologjike nëpërmjet e-forms.



TË GJITHA MASAT E MËSIPËRME DUHET TË JENË TRANSPARENTE NËPËRMJET WEBSITEVE DHE MJETEVE TË TJERA TË INFORMIMIT

